

PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE



ID: 12.3 Institucionet Shendetesore

Emri i Subjektit: "KLINIKA KAJO" SHPK

Administratori: Erjon Kajo

Nipt: L21530002M

Adresa qendrore: Tirane Tirane TIRANE Njësia Bashakiake Nr.7, Rruga "Dritan Hoxha", Pallati "Green Construction", Shkalla 1, Kati 2, Ap.1,2,4

Tirane 2020

Tabela përmbledhese e përmbjedhjes joteknike

1. Instalimi dhe aktivitetet e tij	3
2. Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi	5
3. Burimet e shkarkimeve nga instalimi	6
4. Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes	7
5. Natyra dhe sasi të shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis;	8
6. Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme;	9
7. Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur;	9
8. Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme)	9
9. Masat për përdorimin eficient të energjisë;	10
10. Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi;	11

- Instalimi dhe aktivitetet e tij:

Pershkrimi i subjektit

Subjekti "KLINIKA KAJO" Sh.p.k kryen aktivitetin " Institucionet shendetesore". Subjekti eshte regjistruar ne QKR na date 30.03.2012 dhe eshte themeluar ne date 27.03.2012 ai eshte regjistruar me **Forme Ligjore si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar Sh.p.k**, i pajisur me nr. Identifikim NIPT: L21530002M me Administrator **Z.Erjon Kajo**.

Ky subjekt ushtron aktivitetin e tij ne **ne Njesine Bashkiake Nr.7, Rr. Dritan Hoxha, Pallati "Green Construction", Shkalla 1, Kati 2, Ap. 1,2,4, Tirane.**



Përshkruani instalimin, metodat, proceset, produktet dhe operacionet e instalimit nqse është e nevojshme siguron kopje të planeve, skicave ose hartave dhe detaje të tjera të nevojshme për të përshkruar të gjithë aspektet e aktiviteteve.

Klinika "Kajo" do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e mjeksisë , për kryerjen e vizitave dhe diagnostikimin e sëmundjeve, klinike mjeksore për sëmundjet e përgjithshme e të specialiteteve të vecanta.

Klinika "Kajo" që në projektin e saj është konceptuar që te kryeje analiza-biokimike dhe Mikrobiologjike. Ne këtë laborator me personel të kualifikuar përdoret teknologjia bashkohore e kimisë klinike për realizimin e një game shumë te gjërë të analizave kimiko-biokimike dhe mikrobiologjike . Kjo teknologji eshte bazuar në perdorimin e aparaturave të kontrollit.

Aparaturat e përdorura janë si më poshtë:

**LISTA E APARATURAVE NE LABORATORIN
KLINIK BIODIMIK DHE BAKTEROLOGJIK**

- Cell counter mythic 1 cope
- Fotometer bts biosystems 1 cope
- Koagulometer Siemens 1 cope
- Urinometer uryxon 1 cope
- Fotometer mini vidas 1 cope
- Fotometer i- chroma 1 cope
- Inkubator cloo11 1 cope
- Mikroskop optic 1 cope
- Mikser lab line 1 cope
- Cenrifuge plc series 1 cope
- Banjomari 1 cope
- Frigorifer 1 cope
- Ups on line 1 cope
- Printer epon 1 cope
- Shtrat per marrjen e gjakut
- Banko per marrjen e gjakut
- frigorifer profesional per mbajtjen e kiteve te laboratorit rafte per majtjen e materialeve te konsumit te perditshem ne laborator .
- Kuti te ndyshme per grumbullimin e mbetjeve spitalore
- Lavaman me uje te ngrohte dhe te rrjedhshem per larje dhe pastrim
- Tualet me uje te ngrohte dhe te rrjedhshem.

Bashkëngjitur kësaj teknologjie është dhe do të jetë dhe pajisja e këtij laboratorit me sistem informatik laboratorik (lis laboratoriy informativ system) që shmang gabimet njerezore ne ngaterrimin e mostrave të gjakut të pacientëve dhe njekohësisht dhe në arkivin e të gjithë rezultateve laboratorike të cdo pacienti. Këto rezultate janë disponibël në çdo moment kur pacientit i nevojiten ato për informacion të gjëndjes së tij shëndetësore, për qëllime krahasuese të rezultateve laboratorike.

Të gjitha ekzaminimet kryhen nga një staf mjeko-laborantë të çertifikuar, specializuar dhe me nje përvojë shumëvjeçare. Në vend të metodave të zakonshme dhe klasike të trajtimit, pacientët iu nënshtrohen trajtimit vetjak ,që përcaktohet në bazë te rezultateve të një sërë analizash të hollesishme të kryera nga specialistë. Trajtimi i mbetjeve spitalore kryhet sipas ligjeve në fuqi. Grumbullimin e kontrolluar të mbetjeve spitalore në vende të vecanta, ndarja e mbetjeve të parrezikshme (të llojit urban) nga mbetjet spitalore të rrezikshme.

Amballazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe asgjesisimin në mënyrë të përshtatëshme të mbetjeve spitalore të gjeneruara nga klinika “Kajo”. Plotësimin e formularit të përshkrimit të mbetjeve spitalore të prodhuara nga klinika duke përfshirë: llojin, peshën dhe vëllimin.

Klinika “Kajo” si prodhuese e mbetjeve spitalore ka një regjistër të vecantë të dorëzimit si:

- *Emrin, adresën,*
- *Peshën e mbetjeve,*
- *Datën dhe orën e dorëzimit,*
- *Nënshkruar nga personi përgjegjës.*

Për trajtimin e mbetjeve spitalore **Klinika “Kajo”** ka lidhur nje kontrane 1 vjecare me **firmë Euroteam.**(Kontrata bashkelidhur)



- **Lëndët e para dhe ato ndihmëse, substancat e tjera dhe energjia e përdorur ose e gjeneruar nga instalimi;**

Lendet e para jane bartes te cilesive te produktit. Materialet ndihmese ose ndryshe materialet shtese e përmirësojnë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e produktit perfundimtar por ne kete

aktivitet skemi te bejm me procese prodhimi e si rrjedhoje nuk perdorim materiale ndihmese. Subjekti per ushtrimin e aktivitetit te tij ne Klinike per sherbimet mjekesore qe ofron perdor si lende te pare:

- **Medikamente te ndryshme ne varesi te llojit te specialitetit qe ofrohet**
- **Reagente te ndryshem per kryerjen e analizave te ndryshme**
- **Shiringa, age, bisturi**
- **Maska kirurgjikale, Fasho, pambuk e gareza te ndryshme, leuokoplaste doreza kirurgjikale, etj.**

Si lende ndihmese mund te permendim energjine elektrike dhe ujin, energjia perdoret per ndricimin e ambjenteve te aktivitetit dhe ambjentet e punes per venien ne pune te paisjeve te cilat jane te gjitha elektronike e qe punojne me energji. Uje perdoret vetem ne ambjentet higjeno-sanitare.

- **Burimet e shkarkimeve nga instalimi:**

Shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve te ngurta

Ushtrimi i ketij aktiviteti ne kushte optimale nuk ka ndikim ne nivelin e ujerave tokesore, ne rruget ujore, dhe ne rrjedhen e ujerave nentokesore, pasi nuk ka ndotje te ujit nga, derdhje aksidentale dhe substanca kimike te tjera, pasi ato nuk perdoren ne ne kete aktivitet pasi kemi te bejm me nje aktivitet "Institucion shendetesor". Persa i perket mbetjeve gjate dhenies se sherbimeve jane mbetje spitalore per te cilat subjekti ne fjale disponon kontrate te rregullt me nje subjekt te licensuar, dhe mbetjet qe vijne nga konsumi i perditshem i punonjesve dhe klienteve qe frekuentojne keto ambjente per marrjen e sherbimeve qe ajo ofron.

- 1. Mbetje urbane (mbetjet shtepiake dhe tregetare, mbetjet industriale e institucionale te ngjashme) perfshire fraksionet e mbledhura vecmas.**

KOD 20 01 01 Letër dhe karton

KOD 20 01 02 Qelq

KOD 20 01 39 Plastike

- 2. Mbetje nga kujdesi shendetesor ose shtazor dhe kerkime qe lidhen me to (me perjashtim te mbetjeve te guzhinave qe nuk lidhen drejtperdrejt me kujdesin shendetesor).**

KOD 18 01 01 Bisturite, shiringa, instrumenta te mprehte (pervec 18 01 03)

KOD 18 01 03 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjesimi i te cilave kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet.

KOD 18 01 04 Mbetjet, grumbullimi dhe asgjesimi i te cilave nuk kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet (p.sh. veshje, hedhurinat e leukoplasteve, nderresat, veshje per te asgjesuar, pelena etj)

KOD 18 01 09 Medikamente te tjera pervec atyre te permendura ne 18 01 08

Keto mbetje percaktohen ne baze te **Vendimit Nr. 99, date 18.02.2005 Per miratimin e Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve.**

Te gjitha keto mbetje te listuara me siper me Nr.1 konsiderohen mbetje te parrezikshme pasi nuk kane shkalle te larte ndotjeje ne mjedis dhe nuk kerkojne trajtim te specializuar per asgjesimin e tyre; per mbetjet urbane mjafton qe te depozitohen ne koshat e percaktuara per to nga Pushteti Vendor.

Mbetje nga aktiviteti i Klinikes Jne ato te listuara me siper me Nr.2 nuk do te trajtohen pasi subjekti per keto lloj mbetjesh disponon kontrate me nje subjekt te licensuar per teheqjen e tyre nga ambientet e aktivitetit. Mbetje e ngurta urbane gjenerohen nga aktiviteti i personelit; ato me KOD 20, kurse mbetjet spitalore ato me KOD 18, gjenerohen nga sherbimet qe ofron klinika. Ne baze te Vendimit Nr. 99, date 18.02.2005 Per miratimin e Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve. Sasia e mbetjeve urbane te gjeneruara nga aktiviteti i personelit te punes se ketij aktiviteti eshte **0.0007 ton/muaj**. Sasia e mbetjeve spitalore eshte me shume se **0.017 ton/muaj**.

Sasia totale e gjeneruar e mbetjeve ne vit eshte:

$$\text{TOTALI NE VIT} = 0.0007 * 12 + 0.017 * 12 = 0.0084 + 0.204 = 0.2124 \text{ ton/vit.}$$

Shkarkimet e gazta

Referuar natyres se sherbimeve qe ofron **KLINIKA KAJO**, nuk kemi sasi gazrash te shkarkuara ne atmofer, pasi ne kete aktivitet nuk ka asnje paisje qe mund te shkaktoje ndotjete ajerit dhe duke qene se kemi te bejme me aktivitet shendetesor ajeri duhet te jet shume i pster. Gjate ushtrimit te aktivitetit nuk ka emetime te ndryshme kimike, te cdo lloj qofshin ato. Theksojme se klinika kajo ndodhet ne katin e dyte te nje objekti banimi dhe kjo tregon se ushtrimi I aktivitetit te saj nuk ndikon ne jeten dhe shendetin e banoreve te nderteses.

Rruget ekzistuese te aksesit apo nevoja per hapje te rrugeve te reja

Per zhvillimin e aktivitetit te kesaj klinike nuk eshte nevoja e hapjes se rrugeve te reja pasi infrastruktura eshte ekzistuese, dhe aktiviteti kryhet ne prone private ne emer te pronarit/ te subjektit "KLINIKA KAJO" SHPK.

- Kushtet në vendndodhjen e instalimit dhe rastet e njohura historike të ndotjes;

Kushtet ne vendndodhjen e instalimit jane shume te mira per kryerjen e ketij aktiviteti dhe nuk ka raste te ndotjes ne kete zone. Gjithashtu edhe nga aktiviteti qe do te ushtrohet nuk do te kete ndotje pasi kemi te bejm me nje aktivitet shendetesor i cili nuk shkaktone ndotje.

- **Natyra dhe sasitë e shkarkimeve të pritshme nga instalimi në çdo vend/mjedis, si dhe identifikimi i efekteve të rëndësishme të shkarkimeve në mjedis;**
- **Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve**

Zhvillimi i aktivitetit nuk do të sjell emetime të plhurave në mjedis apo burime të tjera ndotese për ajrin, përveç gazeve të ciluar nga automjetet e transportit të cilat në këto zona ku ndodhet klinika janë pak me shumë se normalja pasi objekti ku ndodhet aktiviteti është rreth rrotullimi I zotit të zi ku dyndja e makinave është e madhe, por që nuk ndikon në aktivitet pasi ato janë në ambient të jashtëm kurse aktiviteti i klinikës ushtrohet në ambient të brendshëm dhe është i pajisur me ventilator për pastrimin e ajrit.

Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis

- **Metoda e zbatuar për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis**

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqen hapat e më poshteme:

- Njohja me projektin dhe shërbimet që ai ofron.
- Njohja me pajisjet dhe aparaturat që shërbejnë për kryerjen e këtyre shërbimeve.
- Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis.
- Njohja me vlerën natyrore dhe mjedisore të zonës dhe vendit ku ndodhet klinika.
- Njohja me infrastrukturën ekzistuese dhe nevojën për infrastrukturë të re për projektin.
- Njohja me lëndët e para që do të përdoren për zbatimin e projektit.

Duke njohur teknologjinë dhe proceset teknologjike nuk u identifikuan ndikime të mundshme negative në receptoret - përberës të mjedisit në objekt.

Identifikimi i ndikimeve – Përmes të cilit u përcaktua ndërpërimi mjedis-projekt i Klinikës Kajo, Zogu Zi, Tiranë dhe u identifikuan ndikimet e mundshme gjatë kësaj faze sipas receptoreve të mjedisit.

Vlerësimi i ndikimeve – Ekspertët mjedisore të fushave të ndryshme bënë përpjekje për matjen e gravitetit të ndikimeve. Vlerësimi i Sinjifikancës ka të bëjë me vetë rëndësinë e ndikimeve dhe është faza më e rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe përfaqëson atë me objektivisht të terësuar e bashkëveprimet midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e përdorura për vlerësimin e rëndësise së ndikimeve variojnë dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit të ndikuar.

- **Shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve të identifikuar (Shkalla)**

Shtrirja fizike- Vlerëson sipërfaqen apo dimensionin hapësiror të një ndikimi të dhënë në raport me burimin që e gjeneron atë ndikim, p.sh. ndikimi në ajër nga gazet e mjeteve të transportit i cili është i shtrirë në ambientet e jashtëm të aktivitetit pa ndikuar në aktivitet por as në aktivitetet e tjera që ndodhen pranë.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlerëson se sa do të zgjase një ndikim i caktuar në dimensionin kohor (ndikim i përhershëm apo i përkohshëm). Në rastin të inibitacionit shëndetësor është një

aktiviteti i perhereshem per aq kohe sa do te jete nevoja per konsumin e produkteve te bulmetit qe prodhon aktiviteti. Ndersa te gjitha ndikimet e tjera negative ne mjedis jane te perkoshme, si shkarkimet ne rrjetin e kanalizimeve etj.

-Kthyesmeria –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar).

-Rendesia – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, aktiviteti ndodhet ne distance te konsiderueshme nga zona me e afert e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i ketij aktivitetit. Zhurma ne kete aktivitet nuk ka pervec zhurmes qe krijohet nga bisedat e mjekeve dhe pacienteve por edhe e mjekeve me njeri tjetër gje e cila nuk eshte shqetesuese eshte Brenda normave dhe nuk ka asnje lloj ndikimi.

- **Teknologjia dhe teknika të tjera të propozuara për parandalimin e shkarkimeve ose, kur kjo nuk është e mundur, për pakësimin e shkarkimeve nga instalimi, veçanërisht duke zbatuar teknikat më të mira të disponueshme;**

Mundesia e zbutjes se ndikimeve dhe argumentimet perkatese nese per ndikime te caktuara nuk mund te zbatohen/ ndermerren masa zbutese

Sic e kemi permendur pothuajse ne te gjithe materialin me siper aktiviteti I KLINIKES KAJO nuk ka ndikime as toke, as ne uje, as ne ajer, as ne zhurma e si rrjedhoje nuk eshte e nevojshme te merren masa per minimizimin e tyre.

- **Alternativën në lidhje me zgjedhjen e vendit të instalimit dhe teknologjinë e përdorur;**

Nuk ka pasur alternativa te tjera pervec kesaj alternative qe ne poseidojm per shkak te pronesise se vendit ne emer te pronarit por edhe ekzistences se klinikes e cila me pare ka operuar po ne te njejtin vend me te njejtin aktivitet por me leje Mjedisi Tipi C duke bere te mundur dhe heqjen e shpenzimeve te qerese pra duke ulur kostot e pronareve per ushtrimin e ketij aktiviteti.

- **Masat për parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve (nëse është e nevojshme);**

Zhvillimi i aktivitetit nuk do te sjell emetime te plhurave ne mjedis, burime te tjera ndotese per ajrin mund te permendim vetem clirimin e gazeve nga mjetet e transportit dhe pse kjo do te jete ne ambientet e jashtme te objektit ku ndodhet klinika Kajo dhe brenda normave pasi automjetet kontrollohen ne menyre periodike.

Gjatë zbatimit të projekteve në terren duhet të mbahen në konsideratë mbrojtja e mjedisit dhe standartet mjedisore si dhe të aplikohen masa konkrete. Çdo zbatim projekti

duhet të shoqërohet me planin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe shmangien e dëmeve mjedisore të panevojshme dhe të pariparueshme. Masat për mbrojtjen e mjedisit duhet të planifikohen dhe zbatohen gjatë operacioneve me ndikim në mjedis si në fazën përgatitore ashtu edhe atë të shfrytëzimit të vendburimit. Në këtë seksion do të trajtohen masat kryesore për mbrojtjen e mjedisit dhe zbutjen e ndikimeve negative të identifikuara në seksionin paraardhës dhe pse nga ushtrimi I ketij aktiviteti nuk ka ndikime me sinjifikance të lartë mjedisore.

Masat e propozuara lidhen me fazat dhe aktivitetin e Klinikës si me mëposhtme:

Masat për zbutjen e ndikimeve negative në mjedis gjatë fazës së kryerjes së proceseve të punës së KLINIKES KAJO dhe Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative:

- Evadimi i mbetjeve urbane sipas legjiskacionit në fuqi.
- Evadimi i mbetjeve spitalore sipas kontratës bashkëngjitur.
- Të kryej auditim të vazhdueshëm të energjisë me ekspert të licensuar.
- Të kryej zëvendesimet e paisjeve jo më vone se 2 vjet.
- Të mirëmbaje në mënyrë të vazhdueshme paisjet që përdoren për ofrimin e shërbimeve.
- Të ketë vëmendjen maksimale ndaj kushteve higjieno-sanitare.
- Të kryej inspektime të përditshme për kushtet higjieno-sanitare dhe për kushtet e punës së punonjësve pasi kemi të bëjmë me një aktivitet shëndetësor dhe për vet llojin e aktivitetit ambientet e tij duhet të jenë gjithë të pastra e të disinfektuara.

-Masat për përdorimin efiçent të energjisë:

Subjekti në fjalë do të furnizohet me energji elektrike nga rrjeti. Aparaturat që përdor ky aktivitet për dhenien e shërbimeve të tij funksionojnë të gjitha me energji elektrike. Thëksojmë se përdorimi i këtyre burimeve nuk ka ndikim në zonë, sepse sigurohen sipas procedurave dhe nga subjekte të licensuara, komform kontratave respektive.

- Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:

- a) janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;
- b) janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktivitetit, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme;

Rreziqe me pasoja ne mjedis

Renien e ndonje zjarri ne ambientin e brendshem te aktivitetit.

Rreziqet me pasoja ne mjedisin human dhe ekonomik

- Aksidentet e punonjesve gjate dhenies se sherbimit.
- Aksidentet si pasoje e renies se zjarrit.

Probabiliteti i ndodhjes per secilin nga rastet e me siperm do te varet shume nga masat mbrojtese qe do te parashikohen dhe zbatohen. Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqerohet me aksidente te cilat mund te sjellin pasoja te demshme ne mjedis si ndotje te ujerave nga lende te rrezikshme, emetime ne ajer nga gaze helmuese etj.

- Monitorimi i planifikuar i shkarkimeve nga instalimi.

Subjekti do te monitoroje aktivitetin e institucionit shendetesor ne disa drejtime sipas nje programi te hartuar per kete qellim. Ne pergatitjen e programit te monitorimit mjedisor merret ne konsiderate mundesia e realizimit te nje monitorimi te elementeve me ndikim ne mjedis. Vetemonitorimi aktivitetit nga subjekti do te behet per ata elemente qe parashikohet se kane ndikim negativ ne mjedis. Te dhenat e marra nga monitorimi do te evidentohen ne regjistrin perkates dhe me rezultatet e matjeve do te informohen organet e administrimit te mjedisit ne qender dhe ne qark. Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vete kompania dhe do te dorezohen ne AKM dhe DRM sa here eshte e nevojshme, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve.

Me **VKM per programin e monitorimit ne RSH** jepen qarte indikatorët mjedisor qe monitorohen, megjithate keta indikator duhet te pershaten dhe ti perkasin veprimtarise. Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine e projektit te zbatuar eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet nese operimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancën mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Nr	Elementi i monitorimit	Frekuenca
2	Monitorimi i gjendjes se aparaturave	Vazhdimisht
3	Monitorim i faktoreve qe shkatojne fatkeqesi natyrore dhe humane.	Vazhdimisht
4	Monitorim i paisjeve per mbrojtje ne rast zjarri ose shkendije elektrike	Vazhdimisht

Indikatorët e mesipërmbledhjes të monitorimit janë një ndërthurje tërësishme me të cilat vlerësohet besueshmëria që ushtron zbatimin e këtij projekti në mjedisin dhe gjendjen e mjedisit, ndikimin dhe funksionimin e projektit të zbatuar në këto objekte. Matja dhe mbledhja e të dhënave për tërësuesit e mesipërmbledhjes do të bëhet nënkonform me metodat dhe teknikat shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mbledhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjera, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim për mirësimin dhe performancën mjedisore të veprimtarisë dhe për të marrë masa korrigjuese të nevojshme. Për të ruajtur të dhënat mjedisore të veprimtarisë do të përgatitet dhe mbahet një regjistër i veçantë ku do të ruhen vazhdimisht të dhënat mjedisore.

PER “KLINIKA KAJO” SHPK

ADMINISTRATOR

Erjon KAJO